

**ERENA HASKA**

## **TIPOLOGJIA E FJALORËVE**

### **Abstrakti**

Përdoruesit e fjalorëve në shumicën e rasteve nuk janë të informuar mbi veçantitë e fjalorëve që i dallon ata nga njëri-tjetri. Njohja e këtyre karakteristikave të veçanta do t'i ndihmojë ata në njohjen e mundësive për një shfrytëzim dhe përdorim të saktë të tyre. Tipologjia e fjalorëve në bazë të kriterëve si gjuha, funksioni, mënyra e prezantimit dhe ndërtimit, qëllimit të ndërtimit, nevojave të ndryshme të përdoruesve, madhësisë etj. ndihmon në sistematizimin shkencor të fjalorëve, si në nivelin konceptual, por edhe në atë gjuhësor.

**Fjalët kyçe:** Fjalorët, Tipologjia e fjalorëve, Karakteristikat e fjalorëve, Leksikografia

### **Hyrje**

Bazuar në “*Fjalorin e Leksikografisë*” (*Dictionary of Lexicography 2001*), tipologjia e fjalorëve është një klasifikim i fjalorëve dhe veprave të tjera referuese... në bazë të veçorive dalluese të tyre... në mënyrë që të mundësohet dallimi i tipave të tyre nga forma, përmbajtja, prezantimi, funksioni, kategoria e informacionit që predominon dhe gjuha<sup>1</sup>.

Ndërtimi i tipologjisë së fjalorëve është një nga aspektet më të rëndësishme të teorisë leksikografike (*dictionary research*) pasi lidhet direkt me aspektet praktike të ndërtimit të fjalorëve<sup>2</sup>. Puna përgatitore me fjalorët fillon me planifikimin e teksteve të koleksioneve, për të vazhduar me përzgjedhjen e njësive leksikore, vendosjen dhe organizimin e zërave leksikografikë, kuptimet e fjalëve dhe mënyrën e përdorimit të tyre duke u udhëhequr gjithmonë nga tipi i fjalorit që gjuhëtari ka vendosur të krijojë<sup>3</sup>. Prandaj edhe tipologjia përkufizohet si një sistem klasifikimi dhe përshkrimi i fjalorëve si njësi leksikografike<sup>4</sup>.

Praktika leksikografike u ka dhënë jetë shumë fjalorëve të tipave të ndryshëm, ndërkohë që teoria leksikografike ndihmon të përcaktojë ndryshimet dhe ngjashmëritë midis fjalorëve të tipave të ndryshëm dhe të

---

<sup>1</sup> R.R.K. Hartman & G. James, *Dictionary of Lexicography*, New York, 2001, f. 145.

<sup>2</sup> N.S. Dash, *The art of lexicography*, në “Linguistic: Nature, history, scope and broad applications”, 2006, f. 28.

<sup>3</sup> Po aty.

<sup>4</sup> P. Swanepoel, *Dictionary typologies: a pragmatic approach*, në “A practical guide to lexicography”, 2003, f. 45.

krijojë një tipologji mbi këtë bazë<sup>5</sup>. Alan Rey është një nga studiuesit që ka propozuar një sistem klasifikimi tipologjik për fjalorët dhe gjatë vlerësimit të tipologjisë së tij ai deklaroi se “... është e vështirë të ndërtohet një dhomë për të gjithë tipat e fjalorëve që janë publikuar dhe shumë sforcim të mirëmbashkoherencën e koncepteve.”<sup>6</sup>.

Bazuar në këtë hulumtim, përpjekjet për klasifikimin e fjalorëve në tipologji të ndryshme kanë filluar që prej vitit 1940, por rezultati nuk ka qenë inkurajues, për shkak të natyrës heterogjene të punës leksikografike<sup>7</sup>. Rezultati ka qenë ekzistenca e një numri të madh tipologjish të propozuara nga gjuhëtarët, të cilët kanë dalluar kategori të gjera të tipave të fjalorëve dhe nënkategori të tyre<sup>8</sup>. Në vazhdim të këtij rezultati, M. Podhajecka<sup>9</sup> argumenton se ekzistenca e shumë tipologjive për fjalorët vjen si rrjedhojë, së pari, e mungesës së një dakortësie mbi një taksonomi për klasifikimin e fjalorëve apo mbi kriteret për klasifikimin e tyre dhe së dyti, e faktit të pashmangshëm të ekzistencës së një shumëllojshmërie të tipologjive, pasi veprat referuese janë të ngjashme në disa aspekte, por mund të devijojnë në disa aspekte të tjera. Ky përfundim justifikohet edhe duke njohur natyrën e fjalorëve, të cilët përtërihen vazhdimisht, përsosen nga ana tipologjike, pasurohen e përditësohen nga përmbajtja leksikore e semantike dhe përshtaten vazhdimisht nga ana funksionale sipas nevojave të përdoruesve<sup>10</sup>.

#### **Rëndësia e një tipologjie shkencore për fjalorët**

Klasifikimi i fjalorëve bëhet sipas kriterëve të ndryshme, të cilat gjuhëtarët i emërtojnë si parametra leksikografikë, karakteristika leksikografike të dallueshme ose dimensione të ndryshme leksikografike<sup>11</sup>. Është e rëndësishme të tregojmë që klasifikimi i fjalorëve përfshin

<sup>5</sup> S. Tarp, *Lexicographica Seris Major: Lexicography in the borderland between knowledge and non-knowledge: general lexicographical theory with particular focus on learner's lexicography*, New York, 2008, f. 113.

<sup>6</sup> Cituar në H.Yong & J. Peng, *Bilingual lexicography from a communicative perspective*, Amsterdam, 2007, f. 61-82.

<sup>7</sup> H. Yong & J. Peng, *Bilingual lexicography from a communicative perspective*, Amsterdam, 2007, f. 61-82.

<sup>8</sup> P. Swanepoel, *Dictionary typologies: a pragmatic approach*, në “A practical guide to lexicography”, 2003, f. 45.

<sup>9</sup> M. Podhajecka, *Historical development of lexicographical genres: some methodological issues*, në “Symposium of New Approaches in English Historical Lexis”, 2009, f. 154.

<sup>10</sup> J. Thomai, *Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë*, në konferencën shkencore “Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë”, 3 dhjetor 2004, 2005, f. 11.

<sup>11</sup> H.Y ong & J. Peng, *Bilingual lexicography from a communicative perspective*, Amsterdam, 2007, f. 61-82.

## Tipologjia e fjalorëve

---

domosdoshmërinë e dallimit midis atyre që konsiderohen cilësitë e fjalorit me fjalorin si vepër<sup>12</sup>.

Ekzistojnë disa lloje të ndryshme klasifikimi si: **a)** *klasifikimi fenomenologjik (phenomenological classification)* që bazohet në karakteristika si forma, përmbajtja etj.; **b)** *klasifikimi funksional* që merr në konsideratë se sa aktiv është konteksti i leksikut të fjalorit; **c)** *klasifikimi morfologjik* që mbështetet në karakteristikat formale të fjalorit<sup>13</sup>.

S.V. Grinov-i<sup>14</sup> shpjegon se problemi kryesor në përcaktimin e një tipologjie klasifikuese për fjalorët lidhet me përcaktimin e kriterëve leksikografike që do të përdoren si bazë për klasifikimin e tyre. Sot leksikografët kanë tendencë të sugjerojnë si kriterë dalluese, parametrat leksikografikë që lidhen me llojin e informacionit që ofron fjalori. Po sipas këtij studiuesi, parametrat leksikografikë mbështeten në interpretimet leksikografike që lidhen me tiparet dalluese të fjalorëve si struktura, tiparet funksionale, dhe tiparet e veçanta linguistike të fjalorit. Ka shumë arsye të besohet që parametrat leksikografikë nuk shërbejnë vetëm si tipare dalluese për të vlerësuar dhe përshkruar llojin e fjalorit, por janë të domosdoshëm edhe në procesin e kompjuterizimit të fjalorëve<sup>15</sup>.

Një nga qëllimet kryesore të tipologjive është të sigurojë për përdoruesit e mundshëm të fjalorit një klasifikim të fjalorëve ekzistues bazuar në karakteristikat dalluese duke ofruar<sup>16</sup>:

1. *vështrim sistematik mbi kategoritë e ndryshme dhe nënkategoritë që janë dalluar midis fjalorëve*; 2. *prezantim të karakteristikave më dalluese të secilës kategori dhe nënkategori*; 3. *qartësim të diferencave dhe korrelacioneve të fjalorëve brenda një kategorie*.

Por sipas studiuesve, qëllimi i ekzistencës së një tipologjie për fjalorët nuk është e lidhur vetëm me përdoruesit. H. Yong-u dhe J. Peng-u<sup>17</sup> kanë formuluar katër konsiderata mbi domosdoshmërinë e ekzistencës së një tipologjie shkencore për fjalorët: *së pari, kontribuon direkt në leksikografi si disiplinë akademike*, e cila normalisht e konsideron tipologjinë si pjesë

---

<sup>12</sup> Z.S.Hawel, *A study on the approaches of classifying dictionaries with and evaluation of dictionaries used by the students of translation*, në "Journal of the College of Arts University of Basrah", 43, 2007, f. 2.

<sup>13</sup> M. Podhajecka, *Historical development of lexicographical genres: some methodological issues*, në "Symposium of New Approaches in English Historical Lexis 2008", 2009, f. 154.

<sup>14</sup> Shih më gjerë, S.V. Grinov, *Some problems of terminological dictionaries and their classification*, në "Aled-LSP Newsletter", 11/2 (27), 1989, f. 3.

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> P. Swanepoel, *Dictionary typologies: a pragmatic approach*, në "A practical guide to lexicography", 2003, f. 45.

<sup>17</sup> H. Yong & J. Peng, *Bilingual lexicography from a communicative perspective*, Amsterdam, 2007, f. 67-68.

themeluese të saj. Teoria leksikografike nuk mund të konsiderohet e kompletuar dhe e krijuar mirë pa një tipologji shkencore për klasifikimin e fjalorëve; *së dyti*, lokalizon fjalorët e tipave të ndryshëm në pozicionin e tyre korrekt. Vëmendja speciale mbi tiparet dalluese të një tipi të caktuar, i dallon ata nga tipat e tjerë të fjalorëve. Zhvendosja e vëmendjes nga tiparet e përgjithshme në ato specifike ndihmon në përmirësimin e cilësisë së krijimit të fjalorëve dhe pasuron studimet si në aspektin teorik të leksikografisë, ashtu edhe në atë praktik; *së treti*, ndihmon në saktësimin e funksioneve leksikografike për çdo tip fjalori me qëllim plotësimin e funksioneve të tyre. Nëpërmjet specifikimit të funksioneve të fjalorit, leksikografët do të kenë një njohje më të mirë të fjalorit gjatë procesit të krijimit të tij; *së katërti*, është në dobi të gjuhëtarëve, botuesve, përdoruesve dhe bibliotekarëve.

#### **Leksikografia botërore – Tipologjia e fjalorëve**

Klasifikimin e parë të fjalorëve e ka prodhuar D'Albert-i në artikullin e tij special në *“Enciklopedia franceze”* në vitin 1754, i cili shënon një nga zhvillimet e mendimit leksikografik të kësaj periudhe<sup>18</sup>. D' Albert-i dallon tre lloje fjalorësh: fjalorët gjuhësorë, fjalorët historikë dhe fjalorët e artit dhe shkencës, të cilët dallojnë nga njëri-tjetri në aspektin e përmbajtjes. Këta mund të konsiderohen edhe si fjalorët e fjalëve, fjalorët e fakteve dhe fjalorët enciklopedikë.

R.T.K. Hartmann-i<sup>19</sup> deklaron që klasifikimi i fjalorëve në tipologji ka filluar në vitin 1940 me gjuhëtarin rus L.V.Sherba, i cili në monografinë *“Opyt Obscej teorii leksikografii”* (1940) bëri tentativën e parë të klasifikimit të fjalorëve ekzistues dhe fjalorëve të së ardhmes bazuar në kundërvënien e tipareve duke themeluar një grup me gjashtë kundërvënie teorike mbi karakteristikat strukturale më të rëndësishme të fjalorëve ekzistues<sup>20</sup>: **1) fjalori normativ kundër fjalorit informativ; 2) fjalori enciklopedik kundër fjalorit me leksik të përgjithshëm; 3) fjalori shpjegues kundër fjalorit thesar të harmonive leksikore; 4) fjalori alfabetik kundër fjalorit ideografik – lëndor; 5) fjalori normativ kundër fjalorit të përkthimit;**

**6) fjalori historik kundër fjalorit jo historik.**

R.T.K. Hartmann-i<sup>21</sup> e vlerëson tipologjinë e Scherba-s si përpjekjen e parë sistematike për të pozicionuar fjalorin në kuadrin e leksikografisë teorike, në të cilën tipologjia e fjalorëve ka një vend të rëndësishëm.

<sup>18</sup> Shih më gjerë, S. Tarp, *Lexicographica Seris Major: Lexicography in the borderland between knowledge and non-knowledge: general lexicographical theory with particular focus on learner's lexicography*, NewYork, 2008, f. 14.

<sup>19</sup> R.T.K. Hartmann, *Lexicography: critical concepts*, vol. III, London, 2003, f. 3.

<sup>20</sup> L.V. Scherba, *Towards general theory of lexicography*, 1940, në *“Lexicography: critical concepts”*, vol. III, London, 2003, f. 11-51.

<sup>21</sup> R.T.K. Hartmann, *Lexicography: critical concepts*, vol. III, 2003, f. 3

## Tipologjia e fjalorëve

Rreth 20 vjet pas publikimit të tipologjisë së Shcerba-s, Yakov Malkiel-i publikoi në librin “*A typological classification of dictionaries on the basis of distinctive features*” (1962) tipologjinë më me shtrirje dhe më me influencë në leksikografinë teorike, që i klasifikonte fjalorët sipas tre kategorive<sup>22</sup>: **a)** gjerësisë; **b)** perspektivës; **c)** prezantimit. Secili kriter u nënshtrohet ndarjeve të mëtejshme. **Kriteri i parë** “gjerësia” ndahet në: **a.1)** numrin e njësisve leksikore; **a.2)** numrin e gjuhëve; **a.3)** sasinë e të dhënave gjuhësore për çdo fjalë. **Kriteri i dytë**, “perspektiva” përfshin tre perspektiva bazike: **b.1)** dimensionin kryesor ose boshtin kohor (diakronik kundër sinkronik);

**b.2)** mënyrën e organizimit të zërave leksikografikë (alfabetikisht, semantikisht); **b.3)** tre nivelet e tonalitetit (i pavarur, ku raportimi i fakteve bëhet objektivisht, në mënyrë didaktike e sipas aspekteve). **Kriterin e tretë** “prezantimi”, Malkiel-i e fokuson në katër pika të dallueshme:

**c.1)** përkufizimi; **c.2)** ilustrimi me shembuj; **c.3)** ilustrimi grafik; **c.4)** karakteristika specifike (lokalizimi i termave bazuar në territorin ose shkallën sociale).

Sipas Geeraerts-it<sup>23</sup>, merita e tipologjisë së Malkiel-it qëndron në faktet që: së pari, kjo tipologji nuk e bën klasifikimin bazuar mbi kategoritë, por propozon një analizë me faktorizim dhe së dyti, kjo tipologji mund të përfshijë të gjitha llojet e mundshme të fjalorëve brenda një kornize të integruar referimi, duke sugjeruar marrëdhënie midis llojeve të fjalorëve dhe duke zbuluar tiparet dalluese të çdo tipi fjalori. Megjithatë, tipologjia e Malkiel-it përballlet me sfida serioze. Sfida e parë serioze vjen nga sistemi i klasifikimit, i cili konsiderohet si i ndërlikuar<sup>24</sup>.

Përpjekje tjetër për tipologjinë e fjalorëve është bërë nga Thomas A. Sebeok-u<sup>25</sup>, i cili e bazon analizën e tij kryesisht në një sondazh “ad hoc” të një numri të limituar të fjalorëve dhe të listave me fjalë të gjuhës Keremis (*Cheremis*). Tipologjia e tij përbëhet nga një grup me shtatëmbëdhjetë tipare dalluese të kontrolluara, të cilat kategorizohen në tre nëngrupe. Nëngrupi i parë zbulon “marrëdhëniet e listave të fjalëve që janë zgjedhur për t’u përfshirë në fjalor”, “mënyrën e përzgjedhjes së fjalëve nga burimet lëndore” dhe “karakteristikat e vetë burimeve lëndore”. Nëngrupi i dytë u referohet marrëdhënieve midis elementëve brenda zërit leksikografik ose paragrafit për

<sup>22</sup> H.Yong & J. Peng, *Bilingual lexicography from a communicative perspective*, Amsterdam, 2007, f. 62-81.

<sup>23</sup> D. Geeraets, *Dictionary classification and the foundation of lexicography*, 1984. [Cituar në H.Y ong & J. Peng, *Bilingual lexicography from a communicative perspective*, Amsterdam, 2007, f. 62.]

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> Analiza për tipologjinë e Th. A. Sebeok-ut mbështetet në studimin e H. Yong & J. Peng, *Bilingual lexicography from a communicative perspective*, Amsterdam, 2007, f. 62. Në rastet kur analiza nuk mbështetet në këtë studim, burimi referohet.

një fjalë a njësi frazeologjike, nëse prezantimi është sintagmatik, organizimi është paradigmatic dhe strukturimi është referues duke iu referuar binarit dallues midis formës dhe domethënies. Nëngrupi i tretë lidhet me *organizimin e zërave leksikografikë në fjalorë bazuar, ose në formën ose kuptimin*. Karakteristika të tjera janë “*ndërveprimi i ngushtë me karakteristikat e burimit*” ose “*karakteristika që nuk janë përfshirë shumë në përkufizimin e fjalorit si një lloj*”.

Tipologjia e Th. A. Sebeok-ut shënoi një zhvillim të mëtejshëm në teorinë leksikografike, por ajo kishte kufizime të qarta dhe mbi të gjitha, kjo tipologji ishte e mbështetur në një numër të vogël fjalorësh. Ajo u bazua në kritere si marrëdhëniet midis fjalorëve, burimeve lëndore nga ku përzgjidheshin fjalët ose marrëdhëniet midis komponentëve të zërit leksikografik, duke lënë fare jashtë aspekte të tjera leksikografike<sup>26</sup>.

Bazuar në studimin e M. Podhajecka-s<sup>27</sup> për tipologjinë e fjalorëve, Alan Rey harton tipologjinë e njohur si “*tipologjia gjenetike*” (1970). Kjo tipologji është skema më e detajuar e prodhuar ndonjëherë për klasifikimin e fjalorëve. Kjo skemë sugjeron që fjalori është rezultat i një serie zgjedhjesh që bëhen nga leksikografi, kur planifikon fjalorin dhe më pas kur e harton atë, të cilat sipas M. Podhajecka-s, duhet të shihen si vlerë për fjalorin. Për të përshkruar në mënyrë adekuate fazat e njëpasnjëshme që lidhen me vendimmarrjen, Alan Rey prezanton dallimet midis:

**a)** “*fjalorëve të studiuar*” dhe “*fjalorëve të lindur të studiuar*”; **b)** *analizës së saktë dhe analizës së nënkuptuar*; **c)** *informacionit funksional dhe jo funksional*.

Përveç këtyre risive, Alan Rey aplikoi edhe një seri me kritere të përdorura edhe më parë në tipologji të tjera, si p.sh. *njësitë leksikore kundrejt njësisve të tjera gjuhësore, renditja formale kundrejt asaj konceptuale të organizimit të zërave leksikografikë dhe gjuha e përdorur për të prezantuar dhe komentuar njësitë leksikografike (metalanguage) kundrejt gjuhës së objekteve (gjuhës humane)*.

Bazuar në studimin e H. Yong-ut dhe J. Peng-ut<sup>28</sup> dhe duke përdorur përkufizimin e C.C. Berg-ut si bazë për dallimet midis fjalorit enciklopedik dhe fjalorit gjuhësor, Ladislav Zgusta dallon vetëm “*llojet më të rëndësishme të fjalorëve*” duke përdorur parametrat: **a)** *boshtin kohor (fjalorët diakronikë*

<sup>26</sup>M. Podhajecka, *Historical development of lexicographical genres: some methodological issues*, në “Symposium of New Approaches in English Historical Lexis”, 2009, f. 155.

<sup>27</sup>Po aty.

<sup>28</sup> Shih më gjerë, H. Yong & J. Peng, *Bilingual lexicography from a communicative perspective*, Amsterdam, 2007, f. 62-81. Për saktësim, analiza për këtë tipologji është mbështetur në këtë studim. Në rastet kur analiza u përket këtyre dy autorëve, bëhet referimi sipas burimit.

## Tipologjia e fjalorëve

dhe sinkronikë); **b)** shkallën e shtrirjes (fjalorët e përgjithshëm dhe fjalorët e specializuar); **c)** gjuhën e prezantimit (fjalorët njëgjuhësh dhe fjalorët dygjuhësh); **ç)** qëllimin e fjalorit; **d)** madhësinë e fjalorit (fjalorët e mëdhenj, fjalorët e mesëm ose fjalorët e vegjël).

Duhet theksuar që Zgusta përdori për herë të parë, si parametër për përcaktimin tipologjik të fjalorëve **qëllimin e fjalorit**. Megjithatë, tipologjia e Zgusta-s nuk është një tipologji sistematike dhe gjithëpërfshirëse, pasi numri i fjalorëve dhe i tipave të fjalorëve të mbuluar është i limituar, duke neglizhuar disa tipa të tjerë fjalorësh. Është i hapur debati, nëse disa prej fjalorëve grupohen në kategorinë e saktë.

Më 1998 është Wiegand-i<sup>29</sup>, i cili krijon tipologjinë e tij të fjalorëve duke dalluar tre lloje të veprave leksikografike referuese: fjalorët gjuhësorë, fjalorët enciklopedikë dhe fjalorët e tjerë (*all round dictionaries*) bazuar në dy kritere: **a)** qëllimi i vërtetë leksikografik gjuhësor për krijimin e fjalorëve gjuhësorë; **b)** qëllimi i vërtetë enciklopedik. Këto dy kritere i formuloi bazuar në fjalorët ekzistues dhe llojet e të dhënave leksikografike të gjetura në këta fjalorë dhe kjo e ndihmoi për t'i ndarë këto të dhëna në dy klasa: në të dhënat gjuhësore dhe në të dhënat jo gjuhësore. Në *"Dictionaries: The Art and Craft of Lexicography"* (1989), Landau<sup>30</sup> ofron një studim gjithëpërfshirës të faktorëve, të cilët luajnë rol në klasifikimin e fjalorëve. Ai prezanton 11 parametra: **1)** numri i gjuhëve; **2)** mënyra e financimit; **3)** moshë e përdoruesve; **4)** madhësia; **5)** qëllimi në aspektin e shtrirjes lëndore; **6)** qëllimi në aspektin e mbulimit gjuhësor; **7)** kompleksiteti i lemave; **8)** gjuha kryesore të tregut; **9)** periudha kohore që mbulohet; **10)** qasja gjuhësore; **11)** mënyra e qasjes.

Klasifikimi i tij duket se vuan nga mungesa e sistematizimit. Veç kësaj, parametrat e klasave të ndryshme dhe niveleve janë vënë në pozita të njëjta dhe janë trajtuar me të njëjtën frymë. Disa parametra nuk janë të aftë për të përmbushur pozitat e tyre si në rastin e parametrave të "mënyrës së financimit" apo "moshës së përdoruesve" etj.. Landau vlerëson që "klasifikimi i tij, nuk ka si qëllim për të qenë një tipologji formale, por vetëm një mënyrë për të theksuar dallimet midis fjalorëve. Kategoritë nuk janë ekskluzive. Ky organizim ofron mundësinë për të shpjeguar dallimet dhe ngjashmëritë midis fjalorëve."

<sup>29</sup> S. Tarp, *Lexicographica Seris Major: Lexicography in the borderland between knowledge and non-knowledge: general lexicographical theory with particular focus on learner's lexicography*, New York, 2008, f. 115.

<sup>30</sup> Shih më gjerë, H. Yong & J. Peng, *Bilingual lexicography from a communicative perspective*, Amsterdam, 2007, f. 62-81. Për saktësim, analiza për këtë tipologji mbështetet në këtë studim. Në rastet kur mbështetet në një burim tjetër, bëhet referimi mbi burimin.

Bazuar në studimin e Piet Swanepoel-it<sup>31</sup> mbi tipologjitë e fjalorëve, prezantohet tipologjia e sugjeruar nga Geeraerts-i në vitin 1984. Kjo tipologji mbështetet në karakteristikat që lidhen me ndërtimin e brendshëm të fjalorit dhe konkretisht me tiparet dalluese që lidhen me makrostrukturën e fjalorit (me ndërtimin në tërësi të fjalorit) dhe me mikrostrukturën e fjalorit (me ndërtimin e çdo njësie leksikografike të fjalorit më vete). Në aspektin e makrostrukturës, Geeraerts-i i krahason fjalorët: **a) sipas shtresimit të fjalësit a burimit, normës a formimit, natyrës së fjalëve a njësive frazeologjike që janë zgjedhur nga gjuha, lemat e të cilës janë përzgjedhur për përshkrimin leksikografik në fjalor; b) sipas parimit themelor të renditjes së lemove (alfabetikisht, sistematikisht apo kombinim i të dyjave).** Në aspektin e mikrostrukturës fjalorët i krahason: **a) sipas mënyrës dhe shkallës së zberthimit kuptimor, si edhe sipas kategorive të informacionit gramatikor për çdo zë leksikografik; b) sipas renditjes së kategorive të informacionit gramatikor brenda njësisë leksikografike.**

Geeraerts-i propozon një listë gjithëpërfshirëse të tipareve që karakterizojnë ndërtimin e brendshëm të fjalorit. Ai pretendonte që këto karakteristika duhet të shërbejnë si themele për leksikografinë, por fatkeqësisht dështoi të ofronte një tipologji të duhur për fjalorët<sup>32</sup>.

B.T.S. Atkins-i dhe M. Rundell-i<sup>33</sup> në librin “*The Oxford guide to practical lexicography*” (2008), pohojnë që parametrat leksikografikë duhet të mendohen shumë qartë nga krijuesit e fjalorëve përpara krijimit të fjalorit dhe në këtë kontekst ata kanë prezantuar tipologjinë e tyre të bazuar në kriteret e mëposhtme: **1) gjuha e fjalorit** që mund të jetë njëgjuhëshe, dygjuhëshe ose shumëgjuhëshe; **2) përmbajtja e fjalorit.** Fjalori mund të përmbajë leksik të përgjithshëm, materiale enciklopedike dhe kulturore, leksik terminologjik, leksik të një fushe specifike të gjuhës; **3) madhësia e fjalorit** që mund të jetë fjalor standard, fjalor i vogël dhe fjalor xhepi;

**4) mediumi i fjalorit** që mund të jetë fjalor i shtypur dhe fjalor elektronik; **5) organizimi i fjalorit.** Njësitë leksikore në fjalorë mund të organizohen nga fjala tek koncepti, ose nga koncepti tek fjala; **6) gjuha e përdoruesve,** i cili lidhet me faktin, nëse fjalori është menduar për një grup përdoruesish që flasin të njëjtën gjuhë, për dy grupe specifike të folësve të së njëjtës gjuhë, ose nxënësve në mbarë botën që flasin gjuhën e fjalorit; **7) aftësitë e përdoruesve.** Përdoruesit mund të jenë gjuhëtarë dhe studiues të gjuhës, nxënësit e

<sup>31</sup> Shih më gjerë, P. Swanepoel, *Dictionary typologies: a pragmatic approach*, në “A practical guide to lexicography”, 2003, f. 46-47. Për saktësim, analiza për këtë tipologji mbështetet në këtë studim. Në rastet kur mbështetet në një burim tjetër, bëhet referimi mbi burimin.

<sup>32</sup> H. Yong & J. Peng, *Bilingual lexicography from a communicative perspective*, Amsterdam, 2007, f. 66.

<sup>33</sup> Shih më gjerë, B.T. Atkins & M. Rundell, *The Oxford Guide to Practical Lexicography*, New York, 2008, f. 24-25.



## Tipologjia e fjalorëve

shkollave, studentët, fëmijët, nxënësit e gjuhës; **8) mënyra e shfrytëzimit të fjalorit** nga përdoruesit.

### Leksikografia shqipe – Tipologjia e fjalorëve

Përpjekje për krijimin e një tipologjie klasifikuese për fjalorët e ndeshim edhe në leksikografinë shqipe. Kjo nuk është rastësi sepse lidhet me faktin që leksikografia shqipe është kristalizuar shkencërisht<sup>34</sup>, si në praktikën leksikografike, edhe në teorinë leksikografike shqipe. Teoria leksikografike shqipe u ndërtua mbi studime të drejtpërdrejta në fushën e leksikografisë dhe të kritikës shkencore për fjalorë të ndryshëm<sup>35</sup>, gjithashtu janë shfrytëzuar për këtë qëllim edhe studime të fushave të tjera të gjuhësisë si studime të gramatikës, të historisë së gjuhës, të dialektologjisë, të etnolinguistikës dhe sidomos të leksikologjisë, të semantikës e të stilistikës<sup>36</sup>. Pjesë e rëndësishme e përpunimit të teorisë leksikografike shqipe ka qenë përcaktimi i klasifikimeve tipologjike për fjalorët dhe pasurimi hap pas hapi i “spektrit tipologjik leksikografik.”<sup>37</sup>

J. Thomai është një nga leksikografët shqiptarë që ka trajtuar tipologjinë e fjalorëve në studimet e tij dhe ka përcaktuar katër kritere për klasifikimin tipologjik të tyre<sup>38</sup>: **1) objekti**, sipas të cilit dallohen dy tipa fjalorësh: fjalorët filologjikë dhe fjalorët enciklopedikë; **2) vëllimi**, ku, sipas këtij kriteri leksikografik, fjalorët njihen nga numri i fjalëve që përmban. Në thelb, ky numër është rrjedhim i zbatimit të një parimi shkencor për hartimin e fjalorit, mbi vëllimin e pasqyrimin të shtresës aktive dhe asaj pasive të leksikut në fjalor. Bazuar në këtë kriter kemi disa tipa fjalorësh: fjalorë xhepi, fjalorë bisedimorë, fjalorë “dore”, fjalorë të vegjël, fjalorë të mesëm, fjalorë të mëdhenj dhe fjalorë “thesarë”; **3) lënda**, sipas të cilit fjalorët mund të jenë të përgjithshëm (të mbarë gjuhës), dialektorë a krahinorë, fjalorë fjalësh, frazeologjikë, sinonimikë, antonimikë, terminologjikë, onomastikë, të autorëve, shkollorë, të fushave të veçanta; **4) trajtimi leksikografik**, sipas të cilit kemi fjalorë shpjegues, dygjuhësh a shumëgjuhësh, alfabetikë a çerdhorë, ideografikë, të anasjelltë, fjalorë elektronikë a konkordancash etj.

Gjithashtu, po në librin “*Leksikologjia e gjuhës shqipe*”<sup>39</sup>, J. Thomai propozon disa kritere të tjera leksikografike, në bazë të të cilave tipi i fjalorit

<sup>34</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 333.

<sup>35</sup> J. Thomai, *Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë*, në konferencën shkencore “Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f. 20.

<sup>36</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 333.

<sup>37</sup> J. Thomai, *Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë*, në konferencën shkencore “Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f. 12-13.

<sup>38</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 305 - 307.

<sup>39</sup> Po aty, f. 305.

përcaktohet nga: **5) natyra e fjalëve që përfshin fjalori; 6) parimet, kriteret dhe zgjidhjet leksikografike që zbatohen në fjalorë;**

**7) shtresimi i fjalësit sipas burimit, normës ose formimit; 8) mënyra e shkallës së zbërthimit kuptimor ose nga ndërtimi i strukturës kuptimore të çdo fjale; 9) zbulimi dhe pasqyrimi i vlerave kuptimore, shprehëse, emocionuese e stilistike i fjalëve.**

Studiuesi R. Memushaj propozon një tipologji për fjalorët të bazuar në katër kritere<sup>40</sup>: **1) sipas synimit, përmbajtjes dhe ndërtimit, fjalorët ndahen në njëgjuhësh, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh.** Fjalorët e tipit të parë u shërbejnë folësve të një gjuhe, kurse fjalorët dy dhe shumëgjuhësh hartohen për t'u përdorur nga folës gjuhësh të ndryshme. Këta të fundit janë fjalorë me përkthim; **2) sipas objektit se çfarë shpjegojnë fjalët apo konceptet që emërtojnë, mund të jenë fjalorë gjuhësorë që merren me shpjegimin e fjalëve dhe fjalorë enciklopedikë që shpjegojnë koncepte; 3) sipas gjerësisë dhe vëllimit, fjalorët janë tre tipash: fjalorë integralë, fjalorë të tipit të mesëm dhe fjalorët e shkurtër; 4) sipas prezantimit, zërat leksikografikë renditen sipas alfabetit, sipas parimit nga koncepti te fjala, me renditje të përmbysur.**

Studiuesi V. Memisha në kumtesën me titull “*Rreth një fjalori shkurtesash në gjuhën shqipe*”<sup>41</sup>, duke cituar përkufizimin e F.J. Hausmann-it mbi fjalorin, analizon përbërësit e rëndësishëm të këtij përkufizimi, duke na sjellë një tipologji për fjalorët bazuar në kriteret: **a) sipas informacionit fjalorët ndahen në gjuhësore dhe jo gjuhësorë; b) sipas mediumit të paraqitjes si mjet shfrytëzimi dhe përdorimi, mund të jenë të shtypur ose elektronikë.**

### **Përfundime**

Ekzistenca e këtyre tipologjive në teorinë leksikografike shqipe është e çmuar, sepse konfirmojnë zgjerimin e fushës së përpunimit të tipave të ndryshëm të fjalorëve gjuhësorë në përpjekje të plotësimit të tipologjisë leksikografike për fjalorët<sup>42</sup>. Ky zhvillim pozitiv duket qartë, jo vetëm në numrin e fjalorëve të botuar, por edhe në cilësinë e prodhimit shkencor të tyre<sup>43</sup>. Pavarësisht kësaj trashëgimie të pasur me vepra cilësore, si në teorinë leksikografike dhe atë praktike, kritika shkencore në leksikografinë shqipe ka vërejtur thujse vetëm mungesat a tepritë në listën e fjalëve, pa mbajtur parasysh **tipin e fjalorit**.<sup>44</sup> Pikërisht ky konstatim është bërë nga një prej personaliteteve më të spikatura shkencore në leksikografinë shqipe, Jani Thomai, i cili u kërkon studiuesve që të përpiqen t'i gjejnë, konceptojnë dhe ftillojnë dukuritë përmes studimeve

<sup>40</sup> R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2008, f. 141-143.

<sup>41</sup> V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011, f. 198.

<sup>42</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 345.

<sup>43</sup> Po aty.

<sup>44</sup> J. Thomai, *Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë*, në konferencën shkencore “Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f. 20.

## Tipologjia e fjalorëve

---

shkencore të thelluara, përmes tipologjive e modelimeve, duke kryer shkëputjen nga studimet e pjesshme a përshkruese<sup>45</sup> dhe duke e drejtuar kritikën leksikografike shkencore të parashtrjës vendin e veprës leksikografike në tipologjinë dhe në spektrin leksikografik të shqipes<sup>46</sup>. Ky punim pohon se ekzistenca e një tipologjie shkencore në leksikografinë shqipe nuk do të kontribuonte vetëm në prodhimin e një kritike leksikografike shkencore, por kjo tipologji së bashku me historinë, strukturën, kritikën leksikografike dhe studimet që lidhen me përdorimin e fjalorëve përbëjnë aspektet teorike të leksikografisë shqipe. Prandaj, duke vlerësuar të rëndësishme këtë aspekt studimor në leksikografinë teorike shqipe, ky studim konkludon se një tipologji shkencore për fjalorët e gjuhës shqipe, një tipologji gjithëpërfshirëse do të ndihmojë së pari, leksikografinë shqipe si disiplinë akademike dhe së dyti, punën e leksikografëve në drejtim të lokalizimit të fjalorëve të tipave të ndryshëm, pozicionimit të tyre korrekt brenda tipologjisë dhe saktësisimit të funksioneve leksikografike që duhet të kenë fjalorët.

### BIBLIOGRAFI

- B.T. Atkins & M. Rundell (2008), *The Oxford Guide to Practical Lexicography*, New York, Oxford University Press Inc.
- H. Yong & J. Peng (2007), *Bilingual lexicography from a communicative perspective*, Amsterdam, John Benjamins Publishing Company.
- J. Thomai (2004, Dhjetor), *Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë*, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore “Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë”.
- J. Thomai (2006), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- M. Podhajecka (2008), *Historical development of lexicographical genres: some methodological issues*, kumtesë e mbajtur në “Symposium of New Approaches in English Historical Lexis”.
- N.S. Dash (2006), *The art of lexicography*, në V. M. Diamnovski & L. Socanac (Ed.), “Linguistic: Encyclopedia of life support system”, (pp. 437 – 475).
- P. Swanepoel (2003), *Dictionary typologies: a pragmatic approach*, në P.G.J. Van Sterkenburg (Ed.), “A practical guide to lexicography”, Philadelphia, John Benjamins Pub.
- R. Memushaj (2008), *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, Toena.
- R.C. Jimerson (2003), Archives and manuscripts, archives and memory. *Oclc System & Services, nr19, vol.3*. Marrë nga Emerald dt 4 Dhjetor 2013.
- R.R.K. Hartman (2003), *Lexicography: critical concepts*, New York, Routledge.
- S. Tarp (2008), *Lexicography in the borderland between knowledge and non-knowledge: general lexicographical theory with particular focus on learner’s lexicography*, në S. Tarp (Ed.), “Lexicographica Seris Major”, vol 34, New York, Max Gniemeyer Verlag.

---

<sup>45</sup> V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011, f. 293.

<sup>46</sup> Po aty, f. 175.

- S. V. Grinov (1989), *Some problems of terminological dictionaries and their classification*, *Alsed-LSP Newsletter*, vol 11, nr. 2 (27).
- V. Memisha (2011), *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, Botart.
- Z. S. Hawel (2007), *A study on the approaches of classifying dictionaries with and evaluation of dictionaries used by the students of translation*, *Journal of the College of Arts University of Basrah*, nr. 43.